

Deklaratë e Grupit të Kontaktit rreth situatës në veri të Kosovës

4 gusht 2006

Grupi i Kontaktit dëshiron të shohë zgjidhjen e statusit të Kosovës në mënyrën e cila do të siguroj të drejtat dhe sigurinë e të gjithë qytetarëve dhe e cila do të vendosë themelin për një shoqëri paqësore, demokratike dhe multietnike. Ne jemi të shqetësuar rreth situatës në veri të Kosovës ku zhvillimet e fundit kanë ngritur tensionet. Anëtarët e Grupit të Kontaktit e ftojnë Beogradin, Prishtinën dhe qytetarët e Kosovës që të ndërmarrin masa për t'u siguruar që pjesa veriore e Kosovës të mbetet një rajon stabil ku respektohen të drejtat e të gjithëve. Bashkësia Ndërkombëtare do të angazhohet gjithnjë e më shumë në pjesën veriore të Kosovës – si para ashtu edhe pas përcaktimit të statusit të Kosovës -- për të ndihmuar në arritjen e këtyre synimeve.

Në këtë drejtim, Grupi i Kontaktit beson që:

1. Pa marrë parasysh se cili do të jetë statusi i ardhshëm i Kosovës, shqiptarët dhe serbët e Kosovës do të duhet të arrijnë marrëveshje praktike për veriun e Kosovës të cilat do të promovonin qeverisje efektive, zhvillim ekonomik dhe besim të ndërsjellë. Ne e ftojmë Prishtinën dhe Beogradin që të arrijnë marrëveshje paraprake rreth këtyre masave përgatitore në kontekst të negociatave për statusin e ardhshëm që udhëhiqen nga i dërguari i posaçëm i OKB-së, Martti Ahtisaari.
2. Decentralizimi i qeverisjes lokale mund t'i ndihmojë komunitetet në veri të Kosovës që ta ruajnë identitetin e tyre dhe të mbrojnë të drejtat e tyre. Posaçërisht, decentralizimi do të mund të lehtësonte ndihmën e ofruar në mënyrë transparente nga Beogradi, si dhe t'iu ofrojë qeverive lokale një autonomi më të gjerë për t'iu përgjigjur nevojave specifike të qytetarëve të vet.
3. Mbrojtja e të drejtave pronësore, liria e lëvizjes dhe kthimi i personave të zhvendosur janë brengë e madhe si për serbët ashtu edhe për shqiptarët në veri të Kosovës. Përcaktimi i statusit duhet të sigurojë implementimin e plotë të këtyre.
4. Duhet gjetur zgjidhjet për qytetin e Mitrovicës. Marrëveshjet e reja, që tani janë duke u diskutuar, duhet të jenë funksionale, realiste dhe duhet të garantojnë të drejtat e të gjithë banorëve.

5. Deklaratat e fundit të kuvendeve komunale në veri të Kosovës të cilat e suspendojnë bashkëpunimin me Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ) janë arsye për brengosje. Ne i ftojmë serbët e Kosovës që të marrin pjesë në institucionet e Kosovës ku ata më së miri do të mund ti promovojnë interesat e tyre.
6. Pas përcaktimit të statusit, do të vendoset një prani ndërkombëtare në Kosovë për të mbikëqyrur implementimin e marrëveshjes mbi statusin dhe për të siguruar të drejtat e të gjithë qytetarëve të Kosovës. Kjo prani do t'i kushtojë vëmendje të posaçme veriut të Kosovës dhe do të ndihmojë në implementimin e dispozitave të marrëveshjes aty.
7. KFOR-i do të mbetet në Kosovë pas përcaktimit të statusit për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të qetë.
8. Si Beogradi ashtu dhe Prishtina duhet të ndërmarrin masa të menjëhershme për të ulur tensionet në veri të Kosovës, e posaçërisht për të inkurajuar një lidhshmëri të përgjegjshme dhe për të ndërtuar besimin mes komuniteteve.
9. Vëmendje e përtëritur duhet kushtuar ringjalljes ekonomike të pjesës veriore të Kosovës. Nxitja e zhvillimit ekonomik do të kërkojë një bashkëpunim në mes të komunitetit serb dhe komunitetit shqiptar të Kosovës.
10. Grupi i Kontaktit e ripohon deklaratën e vet të mëhershme se nuk do të ketë ndarje të Kosovës.